



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR PR/VENDIMIN: “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR VENDOSJEN E VEPRAVE TË ARTIT PUBLIK NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”

Konsultim publik : I Hapur

Data : 04.09.2024

Ora : 10.00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 13, nga të cilat 2 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : “Miratimi i rregullores për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit në territorin e Bashkisë Shkodër”

Pjesëmarrës : Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli. Drejtues dhe Specialistë të Bashkisë Shkodër, qytetarë dhe grupe interesi.(Bashkëlidhur listëprezenca)

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Relaton në mënyrë sintetike sipas materialit të përgatitur **Z.Denis Lesha**, drejtor përgjithshëm i drejtorisë juridike në Bashkinë Shkodër.

Vijon prezantimin e detajuar **Znj.Brikena Leqeja**, drejtoreshë pranë kësaj drejtorie.

Z.Luli pas prezantimit të bërë falenderon grupin e punës për punën e bërë në përgatitjen e kësaj rregulloreje dhe shton se kjo është vetëm njëra nga fazat, pjesa tjetër është marrja në konsideratë e propozimeve që do bëhet nga ana e të pranishmëve dhe qytetarëve. Faza tjetër do jetë kalimi/paraqitja në komisione dhe në përfundim miratimi në Këshillin Bashkiak.

Fjalën e merr **Z.Pal Shkambi**, avokat dhe përfaqësues i qytetarëve shprehet se ai mendon se është bërë një punë e mirë në përgatitjen e kësaj rregulloreje, se ajo përmban elemente sigurie, vlefshmërie dhe është funksionale por në të nuk është e shprehur qartë se cili personalitet duhet vendosur e kush jo si vepër arti. Ai shton se duhet që në rregullore të përcaktohet saktë mosvendosja e veprave të artit për pushtues si p.sh: Hasan Riza Pasha apo shqiptarë që nuk kanë dhënë asnjë kontribut për qytetin e Shkodrës. Veprat e artit duhen vendosur sipas kontributit, peshës dhe rëndësisë që kanë personalitetet që kërkojmë të nderojmë, duke menduar mirë edhe vendin/pozicionin se ku do vendoset.

Z.Plarent Anamali, anëtar i Këshillit Bashkiak citon nenin 11 të rregullores dhe shprehet se mendon se ka paqartësi në rrugën që do ndjekë çdo kërkesë e cila i paraqitet fillimisht Kryetarit të Bashkisë. Gjithashtu ai shton se duhet rishikuar terminologjia.

Përgjigjet **Znj.Leqejza**, drejtoreshë juridike pranë Bashkisë Shkodër duke thënë se çdo kërkesë do i paraqitet Kryetarit të Bashkisë, i cili ia përcjell strukturës përkatëse. më pas kalohet tek Komisioni këshillimor.

Z.Anamali ndalet edhe tek neni 12 i rregullores dhe sugjeron se pjesë e komisionit këshillimor duhet të jetë Kryetari i Bashkisë ose i deleguari i tij. Kryetari i Këshillit ose i deleguari i tij, një anëtar nga opozita dhe një anëtar nga maxhoranca. Pjesa tjetër mund të jetë ekspertë të jashtëm.

Z. Luli kërkon të dijë më shumë lidhur me terminologjinë e përdorur. Duke iu referuar nenit 7 të Pr/Rregullores pyet a është e njëjta gjë kërkesë me propozim? Ai sugjeron që duhet rishikuar pasi gjykon se kërkesa është e hapur për çdo individ kurse propozimi mund të vijë vetëm nga Kryetari i Bashkisë, Prefekti dhe Anëtarët e Këshillit Bashkiak. Ai shton gjithashtu se nuk i duket aspak e llogjikshme që një qytetar të jetë i barabartë me Kryetarin e Bashkisë apo me anëtarët e Këshillit për të drejtë propozimi. Mund të kemi të bëjmë edhe me kërkesa të paligjshme të cilat nuk mund të merren në shqyrtim. Këshilli Bashkiak mund të marrë në shqyrtim vetëm propozime të ardhura nga Kryetari i bashkisë ose nga 1/5 e anëtarëve të Këshillit.

Po ashtu, tek neni 9 pika 5 duhet të dimë se çfarë duhet të përfshijë dokumentacioni shoqërues i kërkesës.

Z.Denis Lesha përgjigjet se kjo pjesë është lënë e hapur, për tu saktësuar në vijim. Po ashtu ai sqaron lidhur me përbërjen e komisionit këshillimor se ai do jetë tërësisht teknik me katër teknikien nga administrata e Bashkisë dhe tre ekspertë të jashtëm. Ai shton se procesi teknik me atë vendimmarrës është i ndarë. Thekson faktin që kërkesa dhe propozimi nuk janë e njëjta gjë. Për më tepër propozimi vjen vetëm nga Kryetari i Bashkisë pas një procesi teknik dhe vendimarrja i takon krejtësisht këshilltarëve.

Z.Luli propozon që në rregullore të përfshihet edhe data base e regjistrimit i të gjitha busteve, memorialeve dhe veprave të artit që janë në territorin e Bashkisë Shkodër.

Z.Petrit Bilali shprehet se të gjitha veprat e artit janë të regjistruara nga Ministria e Kulturës dhe janë të depozituara në drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore. Janë të përfshira të gjitha veprat e artit publik në gjithë territorin e Veriut të Shqipërisë dhe çdo gjë është e kartelizuar. Kurdoherë mund të merret informacion për to.

Përsëri fjalën e merr **Z.Pal Shkambi**, i cili sugjeron që propozimi të jetë më i hapur dhe gjithëpërfshirës, që t'i jepet mundësia shumë personave të propozojnë.

Kryetari i Këshillit kërkon të dijë se çfarë nënkupton koncepti publik dhe ai privat (për hapësirat private)?

Përgjigjet **Z.Lesha** duke thënë se ai personalisht është për heqjen nga rregullorja të kësaj pjese.

Znj.Leqejza sqaron me shembull konkret: Shtëpia e "Pashko Vasës" është monument kulture por ka pronar. Nëse pronarët duan të vendosin një vepër arti brenda territorit të pronës së tyre atëherë do ju nënshtrohen kësaj procedure që i jemi referuar në këtë projekt rregullore.

Z.Brozi, administrator i Njesisë administrative Dajç shprehet se duhet të mendohet edhe si të veprohet me legjitimin e monumenteve që janë bërë tashmë në ambiente private.

Z. Arben Kallaçi, administrator i rajonit nr.4, i cili kërkon të dijë se çfarë nënkuptohet që kanë të drejtë kërkesë 1% e banorëve me të drejtë vote?

Z.Denis Lesha sqaron se përqindja e banorëve është e ndarë sipas ndarjeve territoriale. Është marrë parasysh këtij ligji për vetëqeverisjen vendore.

Znj.Leqejza gjithashtu sqaron edhe njëherë se kërkesa dhe propozimi janë të ndara edhe ligjërisht si koncepte dhe është e caktuar edhe procedura përkatëse dhe se nga kush mund të paraqitet kërkesa dhe propozimi.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka . Dëgjesa për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, Bashkia Shkodër 2024",deklarohet e mbyllur.

SEKRETARE

Sabina Danaj

Mbajtësi i procesverbalit:

Irma Sulishti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË

DËGJESË PUBLIKE: Për projekt vendimin “ Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit publik në territorin e Bashkisë Shkodër”

Date: 04.09.2024

NR.	EMRI MEMERI	LAGJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1	Falë Filipçenli	Stematiçë Shkodër	0689419590	poshtkerc@qalioceb.com	
2	Ermet Hoxhi	Shkodër	0693115928		
3	Agëndua Filipçenli	Ana Malitë	0623256224		
4	Blendar Pashkinatari	N.A. Peshkëmbë	0684442631		
5	Basir Ahmeti	N.A. Dajç	0693672282		
6	Enxhin Haxhiç	Molim 1/1	0696005026		
7	Enxhin Haxhiç	Adm. 1/1	0685324024		
8	Enxhin Haxhiç	SARAJEN	0694028418	elmin.hoxhi@shkoder.gov	
9	Enxhin Haxhiç	Shkodër			
10	Enxhin Haxhiç	Shkodër	0692404375		
11	Enxhin Haxhiç	Shkodër	0692803159	duran.dajç@shkoder.gov	
12	Enxhin Haxhiç	Shkodër	0694784668	gmla@shkoder.gov	
13	Enxhin Haxhiç	Shkodër	0673045896	hida@shkoder.gov	
	Enxhin Haxhiç	Shkodër	0699224549		